



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITRAN


NZ.Nr. / Nr. 07/11

Nr. / Ip. / Dr. /

Data: / Datum 07. 01. 2011

VUSHTRRI - VUČITRAN

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA VUSHTRRI



PLANI I PUNES
SË KRYETARIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2011

dhjetor 2010

Hyrje

Kryetari i Komunës i ushtron kompetencat dhe përgjegjësitë e tij që janë me interes për komunën dhe qytetarët, në pajtim me dispozitat e ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, Statutin e komunës vendimet e kuvendit të komunës dhe aktet tjera nënligjore. Këto kompetenca dhe përgjegjësi realizohen në bazë të planit të tij të punës i cili hartohet në përputhshmëri me planin e punës së kuvendit si dokument bazë në bazë të të cilit zhvillohen dhe realizohen politikat komunale.

Në bazë të ligjit, kryetari i komunës është organ i komunës dhe është përgjegjës për udhëheqjen e ekzekutivit të komunës, mbikëqyrjen e zbatimit të akteve juridike të miratuara në kuvendin e komunës, për propozimin për miratim të buxhetit vjetor të komunës dhe kujdesin për zbatimin e tij, mbikëqyrjen e administrimit të përgjithshëm financiar të komunës, propozimin e rregulloreve, vendimeve dhe akteve tjera për miratim në kuvendin e komunës, raportimin para kuvendit së paku dy herë në vit lidhur me situatën ekonomike e financiare si dhe zbatimin e planeve investuese në komunë, përfaqësimin e komunës për të vepruar në emër të saj, si dhe përgjegjësi tjera të përcaktuara me ligj.

Prioritetet bazë të punës dhe aktiviteteve përmes këtij plani :

- Menaxhimi efektiv dhe transparent i buxhetit të komunës si dhe rritja e të hyrave vetanake të komunës, (kjo do të realizohet përmes rritjes së efikasitetit në punë të ekzekutuesve buxhetor),
- Ngritja e nivelit të përgjegjësisë në punë tek stafi menaxhues dhe secili nëpunës civil.
- Tërheqja e investitorëve të brendshëm dhe të jashtëm me qëllim të zhvillimit ekonomik dhe krijimit të vendeve të reja të punës (përmes vazhdimit të krijimit të kushteve lehtësuese për të i josh bizneset për investime të reja në komunë),
- Rritja e prodhimtarisë bujqësore dhe përmirësimi i cilësisë së atyre prodhimeve,
- Zhvillimi dhe ruajtja e burimeve natyrore si dhe mbrojtja dhe menaxhimi efektiv i mjedisit,
- Ofrimi i shërbimeve sa më cilësorë ndaj qytetarëve,
- Ngritja e cilësisë së punës në institucionet e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm,
- Ngritja e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore,
- Avancimi i vlerave dhe aktiviteteve kulturore atyre të rinisë në lëmin e sportit etj.
- Zhvillimi i infrastrukturës rurale, në veçanti ujit të pijes, kanalizimit dhe përmirësimi i kushteve të jetesës së popullatës në vendet rurale.

BUXHETI DHE FINANCA

Për menaxhimin e financave publike do të përqendrohemi në :

- Menaxhim të mirëfilltë të buxhetit të komunës konform Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, dhe Ligjit për Financat Lokale,
- Transparencë në financa publike ku qytetarët do të kenë çdoherë qasje në shfrytëzimin e parasë publike, e ku shpenzimi i buxhetit të Komunës do të bëhet konform planifikimit buxhetor.

Veprimet konkrete: pregaditjet e para fillestare (treguesit financiar) për buxhetin e vitit 2011:

- Raportimi për mjete e bartura nga v. 2010 në v. 2011,
- Raportimi për pasqyrën financiare për v. 2010,
- Përcjellja e realizimit të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore në çdo 3 muor,
- Barazimi muor i të hyrave dhe shpenzimeve në thesar,
- Propozimi për rishikimin buxhetor për gjysëmvjetorin e dytë të v. 2011,
- Propozimi i buxhetit sipas kornizës buxhetore të MEF-it për v. 2012,
- Propozimi i Draft-rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme.

Buxheti i komunës:

Viti	2010	2011	Indexi
Grandi Qeveritar	8.050.890,00	9.143.438,00	113,57
Të hyrat vetanake	868.719,00	1.343.250,00	154,62
Totali	8.919.609,00	10.486.688,00	117,57

EKONOMIA

Sektori i Biznesit :

- Gjatë muajit janar-shkurt/2011 planifikohet të bëhet hapja e Qendrës Komunale për Biznese(në koordinim me MTI);
- Të gjitha bizneset të cilat ushtrojnë veprimtarin e tyre në territorin e Komunës të pajisen me Leje afariste komunale dhe Leje Profesionale;
- Në muajin Prill-Maj të bëhet kalimi i menaxhimit të tregut të gjelbër në menaxhim privat.

Sektori i Bujqësisë :

- Do të vazhdohet me thellimin e mëtutjeshëm të bashkëpunimit me MBPZHR, OJQ (IADK, Hejfer- Kosova, Rea-Prishtina), me donatorë të ndryshëm (AZHR-Veri,USAID,etj;
- Planifikimi dhe realizimi i të mbjellurave pranverore dhe vjeshtore si dhe ai i korrjeve-shirjeve
- Do të ketë angazhime në mbrojtjen e bimëve dhe kafshëve, përmes bashkëpunimit me Stacionet Veterinare dhe trajnime tjera të ndryshme
- Do të ofrohen shërbime këshillimore për fermerët dhe të interesuarit e tjerë, pastaj;
- Përcjellja e tregut rreth furnizimeve me inpute bujqësore (plehra, farëra, etj) përmes informacioneve dhe këshillave rreth këtyre elementeve të cilat kanë siguri dhe cilësi më nivel;
- Vazhdimi i implementimit të Memorandumeve për Bashkëpunim veçanërisht me IADK-ën në projektet rreth perim-kulturës dhe Hejfer-Kosova në lëmin e blegtorisë rreth projektit për financim me kafshë;
- Përmirësimi i infrastrukturës për ujitje sikur që në vitin e kaluar ka qenë rasti me bashkëfinancimin e projektit me ministrinë e bujqësisë dhe ndërmarrjes "Ibër lepec" për rehabilitimin e sistemit të pompimit dhe rrjetit të ujitjes në rajonin kadastral të fsh. Samadrexhe ndërsa në vitin 2011 edhe me një projekt të njejtë në fsh. Pantinë

Sektori për Pylltari:

- Pastrimi dhe rrallimi i pishave dhe pyjeve në territorin e komunës ku ato gjinden
- Do të shqyrtohet mundësia e formimit të Sektorit për Planifikim të Projekteve pasi që deri më tani kemi pas vështirësi në këtë drejtim

Planifikimi i projekteve kapitale për vitin 2012, është paraqitur në listën e projekteve kapitale të bashkangjitur në shtojcë të këtij plani.

PROKURIMI

Prioritetet: Zbatimi i legjislacionit në fuqi që rregullon procedurat e prokurimit publik e që konsistojnë në procedurë të hapur dhe transparente, Vlerësim objektiv dhe marrje të vendimeve konform rregullatives ligjore, në mënyrë transparente dhe të pa anshme për të gjithë operatorët ekonomik, Trajnimi i personelit në drejtorinë e prokurimit etj.

SHERBIMET PUBLIKE

Prioritetet:

- Përkrahja teknike dhe financiare e iniciativave për ndërtimin e rrjetave primare dhe sekondare të ujësjellësve nëpër fshatra aty ku mungojnë,
- Përkrahja teknike dhe financiare për ndërtimin e rrjetave primare dhe

- sekondare te kanalizimeve nëpër fshatra atu ku mungojnë,
- Ndërtimi i infrastrukturës sipas KAB (Korniza Afatmesme Buxhetore),
 - Angazhimi për gjetjen e donatorëve për ndërtimin e Kolektorit të ujërave të zeza buzë lumit Silnica,
 - Angazhimi për gjetjen e donatorëve për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza,
 - Asfaltimet te reja ne qytet dhe fshatra. Ndërtimi i rrugëve në kubëza, trotuareve dhe parkingjeve publike,
 - Vazhdimi në gjelbërimin e qytetit , ambienteve shkollore, qendrave te mjekësisë familjare, varrezave dhe mirëmbajtja e tyre,
 - Mirëmbajtja e shtratit të lumit terstena,
 - Pastrimi i rrugëve dhe shesheve në qytet si dhe menaxhimi i mbeturinave,
 - Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik dhe mirëmbajtja e tij
 - Mirëmbajtja e rrugëve rregullimi i qarkullimit në komunikacion - sinjalizimi i rrugëve dhe mirëmbajtja e tyre etj.

EMERGJENCA

Prioritetet:

- Hartimi dhe azhurimi i planit për mbrojtje dhe shpëtim.
- Identifikimi dhe analiza e problemeve të lidhura me fatkeqësitë natyrore.
- Organizimi i seminareve me subjektet në teren,
- Sensibilizimi i popullatës për parandalimin dhe zvogëlimin e pasojave nga fatkeqësitë elementare,
- Mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore,
- Evidentimi dhe sistemimi i resurseve njerëzore dhe mjeteve materiale-teknike për nevoja emergjente etj.

ADMINISTRATA

Prioritetet :

- Vlerësimi i punës së nëpunësve civil të administratës dhe sipas nevojës risistemimi i tyre në vende adekuate të punës me qëllim të nritjes së efikasitetit në punë.
- Ngritja e përgjegjësisë dhe disiplinës në punë në nivelin më të lartë të mundshëm.
- Identifikimi i nevojave për aftësim dhe trajnim të personelit ekzistues si dhe plotësimi i vendeve të lira të punës me kuadro me përgatitje adekuate profesionale,
- Ndërtimi i objektit të ri të Komunës i cili do të kushtoj mbi 1.000.000,00 €, e i cili do të financohet nga Komisioni Euvopian.

- Shqyrtimi i mundësive për hapje të zyrave lokale në qendra kryesore lokale të komunës.
- Mirëmbajtja dhe azhurimi i Web-faqes së komunës.
- Angazhimi për hapjen e qendrës për regjistrimin e automjeteve në Vushtrri etj.

URBANIZMI

Prioritetet:

- Do të propozohet miratimi për hartim të planeve rregulluese në tri zona bazuar në planin zhvillimor dhe urban të komunës, si dhe do të shpallet tenderi për hartim të planeve tjera rregulluese sipas planit zhvillimor komunal,
- Aerofotografimi i komunës me qëllim të parandalimit të ndërtimeve pa leje,
- Procedimi për miratim i Rregulloreve dhe vendimeve në Kuvendin e Komunës nga lëmi i urbanizmit etj.
- Hartimin e detyrave projektuese për të gjitha projektet kapitale të aprovuara nga Kuvendi i komunës ku në bazë të këtyre detyrave do të punoheshin pastaj projektet detaje nga Firmat e licencuara për këtë punë.
- Menaxhimi dhe mbikëqyrja e të gjitha projekteve kapitale të cilat financohen nga Kuvendi i Komunës dhe donacionet për këto projekte,
- Pranimi teknik i punëve të cilat janë bërë në bazë të këtyre projekteve etj..

Me PZHK është parapa themelimi i Këshillit Komunal për Zhvillim i cili do të ketë për obligim krijimin e kushteve për zhvillim ekonomik në zonën buzë magjistrales, gjithashtu ky këshill do të organizonte informime dhe këshillime me investues privat gjatë promovimit të partneritetit të pronës private me atë publike. Do të punohet në shfrytëzimin e hapësirave të komunës në partneritetin publiko-privat ose me koncesion.

GJEODEZIA DHE KADASTRI

Prioritetet: Kompletimi i rrjetit gjeodezik rendi i III.

- Përfundimi i lëndëve të komasacionit, zbatimi i kadastarit etazh Regjistrimi i ndërtesave dhe pjesëve të ndërtesave.
- Regjistrimi i përvojave ajrore dhe nëntokësore.
- Shpronësimi i pronave private (sipas nevojës) me rastin e realizimit të projekteve me interes të përgjithshëm.
- Lirimi i pronave komunale dhe pronave publike nga uzurpuesit,
- Rritja e efikasitetit nga ana e organit për realizimin e kërkesave të palëve etj.

SHËNDETSIA

Prioritetet:

- Sigurimi i inventarit të nevojshëm përkatësisht pajisja me mjete mjekësore ose funksionalizimi i Qendrës së re Kryesore të Mjekësisë Familjare në qytet (përball Kop. Bujqësore).
- Instalimi i rrjetit të ujësjellësit me infrastrukturë përcjellëse në ambulancën e fshatit Beqir, për këtë janë planifikuar mjetet mirëpo do të shqyrtohen mundësit përmes donatorëve të ndryshëm që të bëhet gjithashtu edhe ndërtimi i rrethojës dhe instalimi i ujësjellësit me infrastrukturën përcjellëse në ambulancat në Smrekonicë, Lummadh, Maxhunaj, Dumnicë, Pantinë, Novolan dhe Druar.
- Gjithashtu DSHMS në bashkëpunim me institucionet tjerat shëndetësore do të bëjë përcjelljen dhe mbikëqyrjen e situatës epidemiologjike në komunë, aktivitetet e dezinfektimit dhe deratizimit,
- Vizitat sistematike të nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme për zbulim të hershëm të sëmundjeve etj.

MIRËQENIA SOCIALE

Prioritetet:

- Shqyrtimi i mundësisë për ndërtimin e një objekti social, për vendosjen e familjeve të pa strehë. Për këtë do të insistohet në gjetjen e mjeteve nga donator të mundshëm.
- Ndihma për personat dhe familjet në gjendje të rëndë sociale në raste emergjente,
- Mbështetja e fëmijëve pa kujdes prindor.
- Mbështetja e familjeve të dëshmorëve, martirëve, invalidëve, veteranëve dhe viktimave të luftës,
- Parandalimi i delikuencës dhe sjelljeve asociale tek të miturit dhe të rinjtë,
- Orientimi i punës sociale në shëndetësi (përmes infermierisë në komunitet sidomos për personat me gjendje të rëndë shëndetësore dhe pa përkujdesje familjare,
- Bështetja e personave me aftësi të kufizuara përmes shërbimeve shëndetësore falas,
- Rregullimit infrastrukturës për lehtësimin e lëvizjes si përmes shtigjeve, parkingjeve,
- Furnizimi me material ndërtimor për familje të pa strehë etj.

INSPEKTORATI

Prioritetet: Ndërmarrja e masave konform rregullatives ligjore në fuqi për rastet e parregullsive përkatësisht mosrespektimit të ligjshmërisë në lëmin e ndërtimit, tregut, komunikacionit, atë higjieniko-sanitar dhe mbrojtjes së mjedisit, kontrollin e produkteve bujqësore etj.

Plannin e detajuar të Drejtorisë për inspektion ua kemi dërguar në mënyrë elektronike secilit anëtar të KK-së.

ARSIMI

Prioritetet:

- Përmirësim të cilësisë së mësimëdhënies dhe mësimnxënjes duke krijuar kushte optimale për mësim,
- Angazhim të vazhdueshëm për hapësirë të mjaftueshme, mjete konkretizimi të punës etj,
- Subvencionimi i studimeve për studentet e drejtimeve deficitare dhe atyre me gjendje të rënd sociale,
- Përfshirja e të gjitha moshave dhe gjinive në mësimin gjatë gjithë jetës konform regullatives ligjore në fuqi,
- Nngritja e kapaciteteve të reja në infrastrukturën shkollore,
- Ndërtimi i shkollave të reja si: në qytet (shkolla e mesme afër ish Vushteksit), shkollave fillore në fshatin Zhilivodë, Bukosh,
- Renovimi i disa shkollave,
- Sigurimi i ambientit të shëndosh për nxënës dhe personelin shkollor
- Vazhdimi në aftësimin dhe rikualifikimin e stafit arsimorë,
- Meremetimi i shkollave ekzistuese sipas prioritetëve,
- Sigurimi i transportit të nxënësve për viset rurale,
- Përfshirja e të gjithë nxënësve me aftësi të kufizuara në procesin mësimor në shkolla,
- Aplikimi i mësimi parashkollor etj.

Do të përqendrohemi gjithashtu edhe në rregullimin e rrethojave të shkollave dhe objekteve ndihmëse nëpër shkolla, aty ku ka nevojë nëse do të gjenden mjete financiare nga donatorë të ndryshëm..

KULTURË RINI DHE SPORT

Kultura Prioritetet:

- Renovimi i shtëpisë së Mahmut Agë Gjinollit i cili do të mund të shfrytëzohet për muze, arkiv, galeri dhe bibliotekë,
- Ndërtimi i kullës së heroit Azem Bejta, në fshatin Galicë,
- Restaurimi i kullës së Zejnullah Begut,
- Pajisja e bibliotekave me libra.
- Organizimi i mbajtjes së manifestimeve kulturore të komunës:
- Epopeja e UÇK-së,
- Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës,
- Akademia përkujtimore e 2 dhe 22 majit,
- Takimet e poeteshave Shqiptare,

- Dita e Çlirimit,
- Dita e dëshmorëve,
- Ditët e Hasan Prishtinës, (këtë vit nuk do të mbahen sepse ato do të organizohen çdo 5 vite)
- Dita e Flamurit kombëtar etj.

Rinia Në këtë kuadër do të ketë angazhime për;

- Konstituimin e parlamentit rinor të komunës,
- Do të krijohen mundësi për ndjekje të kurseve, seminareve dhe trajnimeve të ndryshme me qëllim të ngritjes profesionale dhe një aftësim sa më bashkëkohorë dhe profesional të rinisë,
- Sensibilizimi i rinisë për rreziqet nga bartja e armëve, mjetet narkotike, fatkeqësitë në trafik etj. si dhe organizimi i debateve të ndryshme me dhe për rininë për këto tema.
- Përkrahja dhe inkurajimi i OJQ-ve rinore duke ju ndihmuar në realizimin e aktiviteteve të ndryshme,

Sporti Ndër prioritetet kryesore që do të realizohen ;

- Subvencionimi i klubeve sportive,
- Krijimi i mundësive që përmes trajnimeve dhe seminareve të ndryshme të bëhet profesionalizimi dhe të rritja e cilësisë së klubeve,
- Mirëmbajtja e objekteve dhe terreneve sportive,
- Organizimi dhe mbikëqyrja e organizimit të garave sportive komunale të nxënësve të shkollave fillore dhe atyre të mesme etj.

ZYRA PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Prioritetet: Fuqizimi i rolit të gruas në Komunën e Vushtrrisë, organizimi i tryezave me OJQ e ndryshme, organizimi i seminareve për komunitetet e ndryshme me temën njohja dhe forcimi i kontakteve në mes të komuniteteve etj.

AUDITIMI I MBRENDSHËM

Prioritetet

- Funksionalizimi i komitetit për auditim të brendshëm të komunës,
- Analiza e kontrolleve të brendshme në të gjitha nivelet e komunës,
- Auditimi i rregullt sipas planit vjetor, por sipas nevojës, edhe auditime të jashtëzakonshme,
- Pjesëmarrje sipas nevojës në trajnime të auditëve dhe ngritje e vazhdueshme profesionale.

ZYRTA LIGJORE

Prioritete: Angazhimi për zbatimin e ligjshmërisë në komunë, Kujdesi për mbrojtjen e pronës përkatësisht pasurisë së komunës si dhe ndërmarrjen e masave tjera të parapara me ligj, për mbrojtjen e interesit të komunës.


Mbajtja e tubimeve Publike me qytetarë.

Tubimi i parë, do të mbahet në fund të muajit qershor 2011, ndërsa Tubimii dytë , do të mbahet në fund të muajit dhjetor 2011

Përfundim

Me gjithë përcaktimin e shumë punëve, detyrave dhe aktiviteteve në këtë plan të punës për vitin 2011 si kryetar i komunës do të insistoj që me punë dhe angazhim të shtuar të jem në funksion të kryerjes edhe të punëve dhe detyrave tjera që nuk janë përfshi në këtë plan të punës përkatësisht në shërbim të të gjithë qytetarëve të komunës, së Vushtrrisë.

Shtojcë: Planet e punës së Drejtorive komunale për v. 2011.

 Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

PROJEKTET KAPITALE TË PLANIFIKUARA PËR VITIN 2011

Tabela 4.2 Financimi vjetor i investimeve kapitale komunale për vitin 2011

Plani 2011, nga										
Nr.	Komuna	Kodi i programit	Programi	Nën-Programi	Kodi i projektit	Pip Kodi	Emri i Projektit	Kostoja totale	Transferet qeveritare	Të hyrat vetanake
Total								3.668.235	2.460.305	1.207.930
644	Vushtrri	TOTALE SHPENZIMET KAPITALE					3.668.235	2.460.305	1.207.930	
		163	Administrata dhe personeli					49.000	-	49.000
		16324	Administrata					49.000	-	49.000
1							Instalimi uësjellësit në zyrën e vendit në Maxhunaj	1.000		1.000,00
2							Orendi për zyrë në administratën e komunës	3.000		3.000,00
3							Furnizimi me kamera për komunën	10.000		10.000,00
4							Furnizimi me teknologji informative dhe pajisje elektronike	5.000		5.000,00
5							Renovimi objektit të komunës	25.000		25.000,00
6							Servisimi dhe mirëmbajtja e teknologjisë informative	5.000		5.000,00
		166	Inspektimet					-	-	-
		180	Shërbimet publike, mbrojtja civile, emergjencia							
		18024	Infrastruktura rrugore					249.572	-	249.571,59
7							Fondi për Bashkëfinancim-Shtruarja e rr. Në kubëza	151.572		151.571,59
8							Shtruarja e trotuareve në qytet	25.000		25.000,00
9							Riasfaltimi i rrugëve	10.000		10.000,00
10							Rregullimi i Kanalizimeve	25.000		25.000,00
11							Furnizim me qypa kanalizimi	25.000		25.000,00
12							Rregullimi i rrugëve të rendit IV	5.000		5.000,00
13							Pilakat Përkujtimore	8.000		8.000,00
		470	Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi rural					2.687.194	2.069.050	618.144
		47024	Bujqësia					2.687.194	2.069.050	618.144
14							Blegtori, Pentani dhe Peninkulturë	25.194		25.194,00
15							Rregullimi i bankinave	15.000		15.000,00
16							Rregullimi i rrg. Dëshmorët e Kombit	100.000		100.000,00
17							Asfaltimi i rrugës Stacioni Hekunthor-Bukosh-Novolan-Bruzniq-Kollë	150.000	150.000,00	
18							Asfaltimi i rrugës Karaq-Skrome	160.000	160.000,00	
19							Asfaltim - Pasome lagja Zahiti-Dauti	150.000	150.000,00	
20							Asfaltimi i rrugës Bukosh-Taraxhë-Akrashicë	50.000	50.000,00	
21							Asfaltimi i rrugës Druar L. Nemozhve	200.000	200.000,00	
22							Asfaltimi i rrugës Ropicë-Vilancë	200.000	91.214,21	108.785,79
23							Asfaltimi i rrugëve në tri Dumnicat	200.000	60.642,00	139.358,00
24							Asfaltimi i rrugës Sllakovic	67.000	67.000,00	
25							Asfaltimi i rrugës Vemicë L. Bunjaku	30.000	30.000,00	
26							Asfaltimi i rrugës Slatinë - Terllabuj	100.000	100.000,00	
27							Asfaltimi i rrugëve Sfaracak	100.000	100.000,00	
28							Asfaltimi i rrugëve Pantinë	110.000	110.000,00	
29							Asfaltimi i rrugës Shallic-Resnik	105.000	105.000,00	
30							Asfaltimi i rrugës Mihalq L. Gela- Bunjaku	70.000	70.000,00	
31							Asfaltimi i rrugës Resnik L. Mustafa	80.000	80.000,00	
32							Asfaltimi i rrugës Ashlan L. Mehmeti-Shyti	50.000	50.000,00	
33							Asfaltimi i rrugës Akrashicë L. Morina	35.000	35.000,00	
34							Asfaltimi i rrugëve Pestovë	70.000	70.000,00	
35							Asfaltimi i rr. Lummadh-Stanovc-magjistrale	200.000	200.000,00	
36							Asfaltimi i rrugëve Bajskë	50.000	50.000,00	
37							Asfaltimi i rrugëve Shtitancë dhe dolak	80.000		80.000,00
38							Asfaltimi i rrugëve Prelluzhë-Riasfaltim	30.000		30.000,00
39							Ndërtimi i murit mbrojtës në Bruznik lagjen Kadriu	10.000		10.000,00
40							Asfaltimi në lagjen Maxhunaj	40.000		40.000,00
41							Asfaltimi i rrugës Stroc (I. Duraku)	120.000		120.000,00
42							Asfaltimi i rrugës Maxhistratë L. Rashicve-Varrezave në f.sh. Begaj	90.000		90.000,00
		660	Planifikimi urban dhe mjedisi					200.000	-	200.000
		66425	Planifikimi urban dhe Inspeksioni					200.000	-	200.000
43							Hartimi i projekteve	20.000		20.000,00
44							Mbikëqyrja e projekteve	45.000		45.000,00
45							Planimi teknik i projekteve	10.000		10.000,00
46							Hartimi i planeve rregulluese	25.000		25.000,00
47							Furnizimi me material ndërtimor	100.000		100.000,00
		660	Kadaster dhe Gjeodozi					35.000	-	35.000
		66425	Kadaster dhe Gjeodozi					35.000	-	35.000
48							Servisimi i aparateve ekzistuese gjeodezike	5.000		5.000,00
49							Shpronësimit e pronave	30.000		30.000,00
		730	Shëndetësia dhe mirëqenia sociale					129.606	129.606	-
		75424	Inspektorati shëndetësor dhe sanitar					129.606	129.606	-
50							Furnizimi me inventar dhe pajisje për QKMF e re	74.606		74.606,00
51							Rentgeni	45.000		45.000,00
52							Instalimi i mjetit të uësjellësit me infrastrukturë përcjellëse (Baqi)	10.000		10.000,00
		850	Kultura, rinia dhe sportet					66.214	-	66.214
		85024	Shërbimet kulturore					66.214	-	66.214
53							Vendimi dhe nxemja në palestren sportive	10.000		10.000,00
54							Blerja e instrumentave muzikore	10.000		10.000,00
55							Rregullimi i fushave rekreative në pesë fshatra (participim)	5.000		5.000,00
56							Restaurimi i kullës së Zejnullah Begut dhe Azem Bejtës	10.000		10.000,00
57							Restaurimi i shtëpisë së Mahmut Agë Gjindit	10.000		10.000,00
58							Blerja e ekspozateve për Muze	1.214		1.214,21
59							Blerja e librave për bibliotekë	5.000		5.000,00
60							Blerja e gardërobës për ansamblin "Hasan Prishtina"	5.000		5.000,00
		920	Arsimi dhe shkenca					261.649	261.649	-
		93690	Arsimi filior					261.649	261.649	-
61							Ndërtimi i shkollës fillore në Zhilvod	60.000		60.000,00
62							Ndërtimi i shkollës fillore në Bukosh	140.000		140.000,00
63							Renovimi i shkollave	41.649		41.649,20
64							Furnizimi i shkollës së muzikës me mjete muzikore	20.000		20.000,00